



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me masat e marra për popullsinë në zonat rurale dhe urbane të Bashkisë Shkodër në situatën e pandemisë COVID-19

Të nderuar,

Në vijim të shkresës suaj administruar pranë Bashkisë Shkodër me Nr.594 Prot, datë 13.01.2021 ju bëjmë me dije se:

1. Çfarë të dhënash disponon Bashkia Shkodër për numrin e qytetarëve të infektuar me COVID-19 nga marsi 2020 deri më 31 dhjetor 2020? A është ofruar ndonjë shërbim për këto qytetar nga Bashkia Shkodër?

Bashkia Shkodër nëpërmjet marrëdhënieve ndër-institucionale është informuar me të dhëna ditore rreth numrit të qytetarëve të infektuar me COVID-19 për periudhën mars-dhjetor 2020. Personat e diagnostikuar pozitiv me COVID-19, të cilët janë identifikuar nga qendrat përkatëse komunitare “Për Familjen” si raste në nevojë, janë telefonuar nga grupi i punës i ngritur pranë Bashkisë Shkodër për menaxhimin e situatës COVID-19 për të vlerësuar nevojat e secilit. Në varësi të nevojave të identifikuar janë ofruar shërbimet e nevojshme dhe janë asistuar me pako ushqimore/higjienike apo dezinfektim banese.

2. Cilat janë shërbimet psiko-sociale që ka ofruar Bashkia Shkodër pas 9 marsit 2020? Cilat janë kategoritë që kanë përfituar duke i ndarë sipas gjinisë, zonës së banimit (zonë rurale/ urbane) dhe nëse i përket një grupi të veçantë si PAK, komuniteti rom&egjiptian, mosha e tretë etj.?

Gjatë kësaj periudhe, shërbimet e ofruara janë si më poshtë:

Shërbime parashoqërore

- Informim

- Orientim
- Këshillim
- Shërbim në familje
- Ndërhyrje e hershme

Shërbime Komunitare

- Mbrojtja e fëmijëve
- Shërbime për fëmijën, familjen, fuqizimin ekonomik, programe prindërimi
- Fuqizim komuniteti
- Shërbime arsimore
- Riintegrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore
- Shërbim për higjenën personale, kujdesin shëndetësor dhe edukimin.

3. A ka Bashkia Shkodër të dhëna nëse është ofruar shërbim psikologjik për të trajtuar ankthin, stresin, depresionin apo probleme të tjera të shkaktuara nga situata e COVID-19? Sa është numri i përfituesve dhe cilat janë kategoritë që kanë marrë këtë shërbim?

Bashkia e Shkodrës përgjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore ka vendosur në dispozicion të qytetarve të saj një numër kontakti për ofrimin e mbështetjes psikologjike për të gjithë kategoritë në nevojë. Krahas kësaj, përmes fushatave të komunikimit online ka shpërndarë në mënyrë të vazhdueshme poste me informacione të nevojshme për marrjen e shërbimeve të ndryshme të ofruara jo vetëm nga Bashkia Shkodër, por edhe organizatat e shoqërisë civile me të cilat bashkëpunon ngushtë.

4. Sa familje në zonat rurale e urbane janë trajtuar me ndihmë Ekonomike në bashkinë Shkodër gjatë muajve tetor- dhjetor 2020? A ka patur ndryshime në shtimin e rasteve të familjeve me ndihmë ekonomike në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019 dhe sa është numri i përfituesve? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë që familjet dhe individët e trajtuar nga Bashkia juaj janë identifikuar në territor me probleme të tjera si psh. Familje me persona me aftësi të kufizuar, fëmijët me autizëm apo tjetër?
5. Sa persona të ndarë sipas gjinisë dhe zonës rurale apo urbane trajtohen me pagesën e paaftësisë për punë (KEMP) të dalë nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) të invalidëve? A ka patur shtim të tyre pas datës 9 mars 2020? Në rastet kur kohëzgjatja e KMCAP ka përfunduar në këtë periudhë dhe kërkon ribërjen e dokumentave nga e para si është vepruar, a e ka penalizuar në vazhdimin e dhënies së pagesave për këtë kategori? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë, nëse po sa burra e gra janë?

Më poshtë gjeni pasqyrën me të dhëna konkrete të numrit të familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020.

Nr. familjeve në skemën e ndihmës ekonomike												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Bashkia Shkodër (Total)	1673	1663	1639	1724	1841	1924	1853	1826	1813	1775	1779	1765
Njësia Shkodër (Qytet)	268	262	251	260	276	283	278	157	268	263	275	270

Bashkia Shkodër rezulton me një numër përfituesish prej 2.52% të familjeve, ku në shkallë republike numri i familjeve përfituese janë mbi 7 %.

Me hyrjen në fuqi të sistemit elektronik kombëtar për ndihmën ekonomike, në kompetencë të Bashkisë mbetet përzgjedhja e përfituesve të ndihmës ekonomike me fonde të kushtëzuar deri në 6%, kjo përzgjedhje bëhet nga familjet e refuzuara për mungesë pikësh nga sistemi elektronik kombëtarë. Përqindje shumë e vogël fondi për të mbuluar nevojat dhe pritshmëritë e të gjithë atyre familjeve që nga sistemi elektronik kombëtar rezultojnë që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme.

Kjo skemë përmbledhet në tabelën e mëposhtme:

Nr. i familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike me fond deri në 6%												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Nr. Familjeve	191	193	185	192	207	207	199	196	207	205	205	205
Fond deri në 6%	530.600	521.732	516.472	530.616	578.944	587.872	564.104	555.464	590.824	554428	555760	552808

Numri i personave përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar për periudhën Janar-Dhjetor 2020:

Nr. përfituesve në skemën e paaftësisë												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Paaftësi	4199	4296	4363	4385	4382	4364	4339	4327	4209	4168	4145	4125
Inv. Pune	3373	3400	3401	3401	3401	3412	3347	3376	3364	3357	3357	3339

Krahasimet me të dhënat e vitit 2019

Më poshtë gjeni pasqyrën me të dhëna konkrete të numrit të familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike gjatë vitit 2019 .

Nr. familjeve në skemën e ndihmës ekonomike												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho r	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Bashkia Shkodër (Total)	1881	1847	1870	1880	1881	1849	1799	1758	1759	1686	1672	1664
Njësia Shkodër (Qytet)	303	277	276	283	287	282	279	274	277	270	275	172

Nr. i familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike me fond deri në 6%												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho r	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Nr. Familjeve	236	232	233	234	233	225	219	214	221	210	205	208
Fond deri në 6%	592 920	585 700	592980	596053	593740	562740	552160	537960	562840	534300	530240	526440

Numri i personave përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar për vitin 2019:

Nr. përfituesve në skemën e paaftësisë												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershori	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Paaftësi	4113	4166	4209	4207	4203	4216	4179	4236	4247	4269	4297	4329
Inv. Pune	3364	3370	3376	3366	3360	3370	3367	3372	3376	3384	3387	3399

6. Sa familje në zonat rurale e urbane përfitojnë përfitim bonus qeraje?

Përsa i përket programit të bonusit të qerasë gjatë vitit 2020 kanë përfituar 3 familje.

7. A keni patur apo trajtuar raste të dhunës në familje gjatë muajit mars-dhjetor 2020? Nëse po sa raste keni patur? Si është trendi i kësaj periudhe krahasuar me një vit më parë?

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, Bashkia e Shkodrës përgjatë periudhës mars-dhjetor 2020 ka trajtuar 73 raste të reja të dhunës në familje, të pajisur më urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje dhe urdhër mbrojtjeje nga Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Shkodër. Përpos rasteve të reja vazhdon menaxhimi dhe monitorimi i urdhërave të mbrojtjes që janë në fuqi nga muajt e mëparshëm (viti 2019).

Gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2019 Bashkia Shkodër ka trajtuar 48 raste të reja me UM.

Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 kujdesi i stafit ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Komunikimi është realizuar përmes telefonit dhe në rastet e nevojshme janë realizuar edhe vizitat në familje në bashkëpunim me SPZ-të e zonës, me të cilët bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë.

Në rastet e nevojshme, pas vlerësimit të situatës dhe nevojave është realizuar edhe mbështetja e rasteve me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare.

Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

8. Cilat janë masat e marra për komunitetin rom dhe egjiptian pas datës 9 mars 2020? Sa është numri i familjeve rom dhe egjiptiane, ku janë vendosur ata në Bashkinë Shkodër dhe cilët janë shërbimet dhe mbështetja që ata marrin nga Bashkia?

Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 Bashkia Shkodër në bashkëpunim edhe me organizatat partnere i ka ardhur në ndihmë komunitetit rom dhe egjiptian duke u munduar të lehtësojë sado pak problemet e shkaktuara nga kjo krizë nëpërmjet shpërndarjes së pakove ushqimore dhe sanitare tek familjet më në nevojë dhe ndërgjegjësimit mbi masat mbrojtëse nga COVID-19.

Familjet e komunitetit rom (140-160 familje në varësi të lëvizjeve dimër-verë) të vendosura përkatësisht në kampet: Prokurori, Zalli i Kirit, Përtej Urës së Bunës, Në Breg të Drinit, Tophanë dhe Beltojë, janë mbështetur me pako ushqimore dhe pako higjeno-sanitare në mënyrë periodike çdo javë përgjatë periudhës mars-qershor dhe çdo dy apo tre javë kur masat kufizuese ndaj COVID-19 kanë filluar të lirohen. Gjithashtu, përgjatë periudhës së gjendjes emergjente është kryer dezinfektimi i këtyre kampeve.

Nga familjet e komunitetit egjiptian të lagjes Liria, 250 familje janë mbështetur me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare, ndër të cilat 50 familje janë asistuar rregullisht.

Përgjatë verës janë ofruar kampe verore për fëmijët e të dy komuniteteve pranë qendrës komunitare « Për Familjen Nr. 5 » dhe qendrës komunitare Multifunktionale. Për fëmijët janë

zhvilluar kurse mësimore, orë edukative, lojra argëtuese si dhe u janë shërbyer dy vakte mëngjes dhe drekë.

9. Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga Qeveria Shqiptare shoqëruar me izolim të detyrueshëm, a keni identifikuar persona të moshës së tretë, që nuk kanë askënd të afërm, apo i kanë fëmijët jashtë vendit? Sa është numri i tyre i ndarë sipas gjinisë? Cilat janë masat që ka marrë Bashkia Shkodër për këtë kategori?

Bashkia Shkodër në kuadër të mbështetjes së kategorive më në nevojë, në kushtet e pandemisë ka asistuar rreth 75 personave të moshës së tretë të cilët janë të vetëm ose nuk kanë fëmijë apo të afërm për t'u kujdesur për ta, të shpërndarë në gjithë Bashkinë Shkodër. Në kuadër të mbështetjes këto raste janë asistuar me pako ushqimore dhe higjieno-sanitare, janë orientuar, këshilluar dhe asistuar për marrjen e pensionit, blerjen e medikamenteve dhe nevojave të tjera në varësi të nevojave të tyre.

10. Sa është numri i individëve me statusin e jetimit të ndarë sipas gjinisë, që jetojnë në Bashkinë Shkodër? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra?
11. Gjatë identifikimit në terren me grupet e punës a keni ofruar ndihmë për individët e papunë, sa nga këta janë burra dhe sa gra dhe cila është ndihma e ofruar? Keni informacion sa është shtuar numri i tyre pas vendosjes së izolimit, vetëkarantimit prej situatës COVID-19. A keni bërë një projeksion të papunësisë?

Individët me statusin e jetimit, vajzat nëna, individët e papunë janë ndër kategoritë në nevojë me prioritet të lartë për Bashkinë Shkodër. Si të gjithë grupet e tjera në nevojë ata kanë marrë mbështetje me pako ushqimore dhe higjieno-sanitare.

12. Në sa familje keni dërguar ndihma dhe në cilat zona e fshatra? Sa është rritur numri i familjeve që kanë nevojë për ndihma pas datës 9 mars 2020? Çfarë përmbajnë këto ndihma? Sa është sasia normale për një familje dhe si dhe sa herë bëhet shpërndarja e tyre?

Një grup i posaçëm, brenda strukturës së Bashkisë Shkodër, është ngritur për verifikimin e familjeve më në nevojë, përgatitjen e planit për shpërndarjen sipas prioriteteve dhe menaxhimin e kontakteve me donatorë të organizatave / shoqatave / fondacioneve të ndryshme, të cilët kanë shprehur gadishmërinë e tyre për bashkëpunim.

Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e informacionit transparent për qytetarët ka qenë një pjesë e rëndësishme për ndërgjegjesimin mbi seriozitetin e situatës, sensibilizimin e opinionit publik dhe ndërmarrjen e masave higjieno-sanitare nga gjithsecili.

Numri i njerëzve të identifikuar në rang bashkie si persona në nevojë për mbështetje ka qenë rreth 6,200 persona. Nisur nga kufizimet për efekt të përhapjes së epidemisë COVID-19, mbështetja me pako ushqimore dhe higjienike ka filluar me datë 17.03.2020, me familjet më në

nevojë, në komunitetin rom në vendqëndrimet e tyre: Prokurori, Tophanë, Përtej Urës së Bunës, Në Breg të Drinit, Zalli i Kirit dhe Beltojë.

Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, nga data 11.03.2020 deri 23.06.2020, janë mbështetur me pako ushqimore dhe higjienike 4,962 familje në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, sipas prioriteteve. Territori i Bashkisë Shkodër shtrihet nga Njësia Administrative Theth deri në Njësinë Administrative Velipojë dhe më poshtë është e paraqitur shpërndarja sipas Njësive.

Njësia Administrative	Familje total
Shkodër	3520
Nj. A. Rrethina	370
Nj. A. Ana e Malit	92
Nj. A. Postribë	148
Nj. A. Guri i Zi	142
Nj. A. Dajç	50
Nj. A. Velipojë	72
Nj. A. Berdicë	119
Nj. A. Shosh	170
Nj. A. Pult	142
Nj. A. Shalë	137

Pako ushqimore dhe jo-ushqimore janë shpërndarë çdo ditë gjatë periudhës kohore në fjalë. Intensiteti ka qenë më i lartë gjatë muajve Mars – Maj, ndërsa me hapjen graduale të aktiviteteve numri i familjeve kërkuese ka shkuar drejt rënies. Familjet e identifikuara me prioritet të lartë janë ndihmuar disa herë dhe vazhdojnë të mbeten në vëmendjen e shërbimeve tona. Pas përfundimit të gjendjes emergjente, datë 23 qershor, deri tani janë shpërndarë edhe rreth 1000 pako të tjera ku, grupi më i ndjeshëm, ku mbështetja ofrohet në mënyrë të vazhdueshme janë familjet e komunitetit rom dhe herë pas here familjet në nevojë të komunitetit egjiptian.

Grupi më i ndjeshëm, ku mbështetja është ofruar në mënyrë të vazhdueshme kanë qenë familjet (140) e Komunitetit Rom dhe herë pas here familjet në nevojë të Komunitetit Egjiptian.

Ndërkohë, janë asistuar rreth 75 të moshuar që jetojnë vetëm, në kryerjen e pazarave, blerjen e ilaçeve apo shërbimeve të tjera në varësi të nevojave specifike të tyre.

Për informacion më të detajuar, vizitoni faqen web të Bashkisë Shkodër, ku mund të gjeni raporte të detajuara ditore për punën që është bërë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

13. A ka patur ndryshim, të Buxhetit të Bashkisë Shkodër pas vendosjes së masave të marra për situatën COVID-19? Nëse jo, si përballat kjo situatë nga Bashkia dhe nëse po si dhe ku janë reflektuar këto ndryshime?

Bashkia Shkodër ruan rezervat e saj ushqimore në rast të emergjencave civile (tërmet, përmbytje, apo situata të tjera të paparashikuara) ndaj ka qenë e mundur ndërhyrja e menjëhershme në familjet në nevojë, sapo kanë filluar të shfaqen rastet e para të koronavirusit në Shqipëri dhe kanë filluar kufizimet e para datë 11.03.2020.

Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 243, dt. 24.03.2020 *“Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”* ka shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Ministria e Mbrojtjes me shkresën Nr. 1650, dt. 24.03.2020, *“Kërkesë për marrjen e masave urgjente për përdorimin e fondeve për mbrojtjen civile”*, ka dërguar vendimin e Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës Nr. 2, dt. 24.03.2020 *“Për përcaktimin e masës së produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore minimale dhe llojet e procedurave të asistencës ndaj shtresave në nevojë”*, duke dhënë orientimin që të përdoren fondet e planifikuara nga Bashkitë për mbrojtjen civile.

Në vazhdimësi, me Vendim Nr. 87, me Nr. 5073/3 Prot., dt.25.03.2020, është miratuar nga Bashkia Shkodër rishpërndarja e fondit të zërave të shpenzimeve korente, brenda programit *“Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”* me burim financimi transfertë e pakushtëzuar, për shkak të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Kjo rishpërndarje është kryer nga aktiviteti *“Zvogëlimi i riskut nga fakeqësitë dhe mbrojtjen civile”* dhe fondi prej 4,915,000 lekë është përdorur për blerjen e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore për shtresat në nevojë sipas referencës përkatëse në Vendimin Nr. 2 të lartpërmendur, i cili në shtojcën 1 të tij përcakton edhe masën minimale të produkteve për një periudhë dy-javore. Gjithsej ky fond ka mbuluar pako për 839 familje në nevojë.

Në proces e sipër, mbetet një tjetër fond i alokuar me të njëjtën bazë ligjore dhe për të njëjtin qëllim me vlerë 5,219,312 lekë.

Për më tepër, bashkëpunimi i afërt me organizata të ndryshme (UNICEF, UNDP, World Vision, Fundjavë Ndryshe, Foodbank, Mirësia, Shpresë për Botën, etj.) ka bërë të mundur mbulimin më të gjërë të familjeve në nevojë me pako ushqimore dhe higjienike. Në këtë kuadër janë kryer dy dhurime financiare. UNICEF ka dhuruar një fond me vlerë 2,333,600 lekë për 553 familje në nevojë. Fondi është administruar nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Postën Shqiptare dhe

u është shpërndarë familjeve në varësi të numrit të anëtarëve. WorldVision ka dhuruar një fond me vlerë 250,000 lekë që u është shpërndarë 50 familjeve në nevojë.

14. Referuar kategorisë së të rinjve a ka ndonjë masë ose kërkesë specifike të ndërmarrë nga Bashkia Shkodër? A ka të rinj të rikthyer nga jashtë Shqipërisë së fundmi pas datës 9 mars? Çfarë shërbimi po ju ofrohet atyre?

Të rinjtë, si të gjithë grupet e tjera kanë marrë shërbimet e nevojshme në varësi të nevojave specifike të tyre.

15. Cilat janë mjetet dhe mënyrat që komunikoni me qytetarët në njësi administrative dhe në qytet për shërbimet që ofroni gjatë periudhës së izolimit/ vetëkarantinimit të detyrueshëm?

Bashkia e Shkodrës përgjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore ka vendosur në dispozicion të qytetarve të saj një numër kontakti për komunikimin dhe ofrimin e shërbimeve për të gjithë kategoritë në nevojë. Krahas kësaj, përmes fushatave të komunikimit online ka shpërndarë në mënyrë të vazhdueshme poste me informacione të nevojshme për marrjen e shërbimeve të ndryshme të ofruara jo vetëm nga Bashkia Shkodër, por edhe organizatat e shoqërisë civile me të cilat bashkëpunon ngushtë.

Në dispozicion të qytetarve kanë qënë dhe janë gjatë të gjithë kohës të gjitha mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe adresa zyrtare e email-it.

Komunikimi me qytetarët është realizuar edhe përmes kontaktit direkt me administratorët shoqëror të çdo lagjeje.

Për informacion më të detajuar, vizitoni faqen web të Bashkisë Shkodër, ku mund të gjeni raporte të detajuara ditore për punën që është bërë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Voltana Ademi